



# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E hënë, 4 korrik 2016

## PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3295, datë 18.5.2016	Me objekt kërkesën për çeljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “AGC Retail” sh.p.k., me NIPT: K91519017K, bazuar në nenet 11, 13, 15, 19(3), 30(1)(b) e vijues të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.....	3
Vendim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 5992, datë 9.6.2016	Me objekt hapjen e procedurës së falimentit të shoqërisë “G&T” sh.p.k. me NIPT: K31902010N.....	7
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 7306, datë 17.6.2016	Me objekt fillimin e procedurës së falimentit për pasuritë e shoqërisë “Arbi-D” sh.a., për shkak të paftësisë paguese dhe mbingarkesës me borxhe të saj.....	13
Njoftim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 1113/6, datë 23.6.2016	Lajmërim publik shoqërisë “Albania Oil Refinery” sh.a. për zgjidhjen e Kontratës Koncesionare “Për rehabilitimin e rafinerisë së Cërrikut”, rrethi Elbasan, lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a.....	19



## VENDIM

Nr. 3295, datë 18.5.2016

PËR ÇELJEN E PROCEDURËS SË  
FALIMENTIMIT- FAZA E PARË

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Rezarta Mataj – gjyqtare,**

me sekretare gjyqësore Elona Molla, në Tiranë, sot, në datën 18 maj 2016, ora 11:30, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile-tregtare që i përket:

**KËRKUES:** Shoqëria “AGC Retail” sh.p.k., me NUIS: K91519017K, me adresë: Autostrada Tiranë–Durrës, km 14 Tiranë, me administrator Elson Bajlozi, e përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Xharije Nela dhe/ose Alma Zyba anëtare të Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**PERSON I TRETË:** 1. Shoqëria “City Park” sh.p.k., me NUIS: K72315012N administrator Eraldo Boni, me adresë Autostrada Tiranë–Durrës, fshati Gjokaj, në godinën “Holding”, pranë OLIM-it.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Dega Rajonale Tatimore Tiranë dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë (në mungesë).

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dega Tiranë (në mungesë).

**OBJEKTI:** Kërkesë për çeljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “AGC Retail” sh.p.k., me NIPT: K91519017K, bazuar në nenet 11, 13, 15, 19(3), 30(1)(b) e vijues, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

- Në bisedimet përfundimtare, përfaqësuesja e kërkuarit pretendoi: “Pranimin e kërkesës si e mbështetur në ligj dhe në prova”, ndërsa personat e tretë, në mungesë, gjatë seancës së fundit të gjykimit.

- Gjykata, pasi zhvilloi hetimin gjyqësor, konsultoi çështjen në tërësi në ligj material, procedural, prova dhe formoi bindjen e saj të brendshme

## VËREN SE:

1. Shoqëria “AGC Retail” sh.p.k., i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (më tej

GJRRGJ-ja Tiranë) me objekt e bazë ligjore si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. GjRRGJ-ja Tiranë, seksioni tregtar i saj ka kompetencë lëndore dhe tokësore si gjykata në rrethin gjyqësor të të cilit ndodhet selia e shoqërisë debitore që kërkon të deklarohet falimentimi, konkretisht në Tiranë, sipas nenit 4, të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

3. Në gjykim, gjykata, kryesisht, sipas nenit 193 të KPRC-së dhe nenit 17§2 të ligjit nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, thirri në cilësinë e personit të tretë, kreditorët e mundshëm, të cilët rezultuar nga raporti i administores së përkohshme, konkretisht Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, Drejtorinë e Doganave Tiranë dhe shoqërinë “City Park” sh.a.

**II. Mbi rrethanat dhe faktet e çështjes**

3. Sipas statutit dhe ekstraktit të thjeshtë të QKR-së të shoqërisë “AGC Retail” sh.p.k., datë 4 nëntor 2015, si dhe ajo historiku të printuar nga gjykata pasi u bë këqyrja *online* në faqen elektronike [qkr.gov.al](http://qkr.gov.al), bazuar në nenin 286 të KPRC-së, kjo shoqëri mbart këto të dhëna: e regjistruar në datën 19 mars 2009, me NUIS: K91519017K, me adresë: rruga “Llambi Bonata”, nr. 19, kati 4, ap. 11, Kombinatat, Tiranë, me objekt të veprimtarisë: “Tregtim tekstilësh, konfeksionesh, import-eksportin e tyre, tregtim me pakicë brenda vendit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. Shërbim konsulence financiare dhe shërbim konsulence ligjore.”. Me status të pezulluar.

4. Sipas kërkuarit, kjo shoqëri ka rezultuar sipas bilanceve të tri viteve të fundit me humbje dhe për këtë arsye i është drejtuar gjykatës për shpalljen e falimentimit të saj për shkak të mbingarkesës në borxhe dhe paaftësisë paguese të saj.

5. Konkretisht, me vendimin nr. 6131 Akti, datë 25 nëntor 2014, është lëshuar urdhri i ekzekutimit të kreditorit “City Park” sh.a., me debitor “AGC Retail” sh.p.k., në shumën prej 315 000 eurosh, e cila po ekzekutohet nga shoqëria përmbarimore “L&K dept collections”



sh.p.k. Po ashtu, sipas vërtetimit nr. 11644 prot., datë 29 tetor 2015, shoqëria “AGC Retail” sh.p.k. ka ndaj Degës Doganore Tiranë, shumë prej 10 444 176 lekësh, ndërsa ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, shumë prej 1 118 285 lekësh, e provuar me vërtetimin e datës 17.12.2015.

6. Nga verifikimi i bankave të nivelit të dytë, shoqëria “AGC Retail” nuk ka shuma monetare të depozituara në llogari bankare pranë tyre ose ato janë mbyllur përveç “Procredit Bank” sh.a., ku ka një llogari aktive në shumë prej 324.46 lekësh. Sipas vërtetimit të ZVRPP-së Tiranë të vitit 2015, nuk rezulton se kjo shoqëri të ketë pasuri të paluajthme të regjistruar. Sipas vërtetimit datë 21 shtator 2015 në Drejtorinë Rajonale Tiranë të Shërbimit të Transportit Krugor nuk ka asnjë mjet në pronësi të subjektit “AGC Retail” sh.p.k.

7. Në gjykim u paraqit në cilësinë e provës edhe pasqyra financiare e shoqërisë për vitin 2013.

8. Vetë administratori i shoqërisë, Elson Bajlozi, deklaroi nën përgjegjësinë e tij të plotë se të gjitha të dhënat bashkëngjitur kërkesës për hapje procedure falimentimi janë të sakta.

9. Në gjykim, gjykata caktoi si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Mimoza Cara, nga ku sipas pyetjeve të shtruara nga gjykata iu përgjigj me raportin e datës 31 mars 2016, në këtë mënyrë:

“1. Shoqëria “AGC Retail” sh.p.k. ka aktive në inventar vlerën prej 1 306 942 lekësh (shumë monetare në arkë, makineri dhe lëndë të parë - prodhim veshje) totali i detyrimeve është në shumë 55,637,691 lekë (për tri subjektet kreditore), pra raporti aktive me pasive është 1:42.57. Vlera e aktiveve është e pamjaftueshme për likuidimin e detyrimeve të maturuara në datën 4 nëntor 2015. Prandaj është në kushtet e hapjes së procedurave të falimentimit.

2. Pasuritë e debitorit janë të pamjaftueshme të mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, ku vetëm pagesa e administratorit në muaj, nisur nga aktivi, është 70 000 lekë/muaj. Po ashtu statusi i shoqërisë është i pezulluar dhe mund të mos ketë likuiditete.

3. Në lidhje me masën e sigurimit në fillim duhet të vlerësohet pasuria e më pas të diskutohet për masa të tilla.

4. Nuk ekziston mundësia për të vazhduar veprimtarinë e tij si debitor, pasi vetëm detyrimet kanë arritur në masën 185 012 689 lekë.”.

10. Në gjykim pasi dëgjoi edhe pretendimin e palës kërkuese, i cili është i gatshëm të parapaguajë shpenzimet e procedurës së falimentimit, gjykata, në përputhje me nenin 19§1 të ligjit për falimentimin, vendosi që debitori të derdhë këtë shumë shpenzimesh në një llogari bankare të hapur nga administratorja e falimentimit. Rezulton se në llogarinë bankare pranë bankës BKT sh.a. është derdhur shuma prej 1 000 000 lekësh nga “AGC Retail” sh.p.k., për administratoren e përkohshme të falimentimit, Mimoza Cara.

### III. Legjislacioni i zbatueshëm

11. Ligji nr. 8901/2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Neni 13

#### Shkaku i hapjes së procedurës së falimentimit

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.

2. Gjendja e paastësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paastë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paastësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat.

3. Nëse hapja e procedurës së falimentimit kërkohet nga vetë debitori, paastësia paguese në një të ardhme të afërt përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori ndodhet në gjendjen e paastësisë paguese në një të ardhme të afërt, kur nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit.

4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë.

Procedurat për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës.

5. Kriteret dhe mënyrat e përllogaritjes së treguesve ekonomikë, mbi të cilët fillojnë procedurat e falimentimit, caktohen nga Këshilli i Ministrave.”.



## Neni 15

**Kërkesa e debitorit**

“1. Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj, duhet të paraqesin:

a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë;

b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, duhet të përmbajë edhe një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

3. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk i kanë dorëzuar të gjitha deklaratat dhe dokumentet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i kërkon atij plotësimin e tyre. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk e zbatojnë kërkesën e mësipërme brenda 15 ditëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit rrëzon kërkesën e drejtorëve, zyrtarëve, ortakëve apo aksionarëve të shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, për hapjen e procedurës së falimentimit.”.

## Neni 18

**Shqyrtimi i çështjes dhe dhënia e vendimit për hapjen e procedurës së falimentimit**

“...

4. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni, vendos:

a) rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkakut ligjor për hapjen e procedurës së falimentimit;

b) rrëzimin e kërkesës për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurive të debitorit për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Kundër vendimit të seksionit tregtar të gjykatës së rrethit për pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurës së

falimentimit ose për rrëzimin e kësaj kërkesë, mund të bëhet ankimi i veçantë nga debitori ose kërkuesi për hapjen e procedurës së falimentimit.”.

**IV. Vlerësimi i gjykatës bazuar në ligj dhe në prova**

12. **Shkaku** - Sipas nenit 13 të ligjit të posaçëm, falimentimi është shkalla më e fundit e pamundësisë së një personi juridik për të vazhduar veprimtarinë e tij e më pas për t'u mbyllur pasi të ketë likuiduar debitorët e tij.

12.1 Falimentimi i një shoqërie, duke qenë mënyra më e fundit e mbylljes së veprimtarisë së saj, përveç prishjes, likuidimit ajo duhet të hapet gjithmonë me shkak. Shkaqet kryesore të hapjes së procedurës së falimentimit janë: mbingarkesa në borxhe për shoqëritë tregtare dhe/ose paaftësi për të paguar detyrimet, e cila mund të jetë e afërt ose e largët. E para nënkupton kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe, në bazë të rrethanave, pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë, ndërsa e dyta nënkupton kur debitori nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit.

13. **Subjektet** - kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit mund ta bëjnë në gjykatë kreditori/ët, debitori ose organet tatimore. Secili prej këtyre subjekteve duhet të përmbush një sërë kërkesash para Gjykatës mbi kushtet e falimentimit.

14. Në rastin konkret, kërkuesi është vetë debitori, i cili, sipas nenit 15 të ligjit, duhet të plotësojë këto kushte për hapjen e procedurës së falimentimit:

- kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit;

- listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë;

- listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre;

- një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.



15. Në rastin konkret, nga ana e shoqërisë “AGC Retail” kërkohet çelja e procedurës së falimentimit për shkak të paaftësisë paguese dhe mbingarkesës në borxhe karshi “City Park” sh.a., Drejtorisë së Tatimeve Tiranë dhe Degës së Doganës Tiranë, të saj, e cila u provua me dokumentacionin e paraqitur në gjykatë sipas pikës 14 të këtij vendimi. Rezulton se shoqëria ka një raport mes aktivëve dhe pasivëve 1:45.57 ku totali i aktivëve është 1,306,942 lekë ndërsa totali i pasivëve 55 637,691 lekë. Kjo situatë financiare, sipas ligjit dhe administrores së përkohshme të falimentimit përbën shkak real të falimentimit.

16. Nga pikëpamja formale janë paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji për falimentimin, e të paraqitura në gjykatë nga ana e kërkuarit nga organet tatimore, doganore, përmbartimore, bankat e nivelit të dytë, ZVRPP-ja Tiranë, Drejtoria e Transportit Rrugor Tiranë, deklaratën e administratorit të “AGC Retail” sh.p.k. se të dhënat janë të sakta etj.

17. Në kushtet kur debitori derdhi në favor të mbulimit të shpenzimeve të procedurës, shumën e kërkuar nga administratorja e përkohshme e falimentimit gjykata çmon se sipas nenit 18§c të ligjit 8901/2002, kërkesa për të deklaruar të hapur procedurën e falimentimit për “AGC Retail” sh.p.k. duhet pranuar.

18. Me hapjen e kësaj procedure në orën dhe në datën e shpalljes së këtij vendimi në datën 18 maj 2016 gjykata ka për detyrë të njoftojë publikisht institucione të parashikuara nga nenet 26–31 të ligjit nr. 8901/2002, me qëllimin që të vihen në dijeni për pezullim të veprimeve të mëtejshme, të bëjnë shënime në regjistrat e tyre për të paralajmëruar personat e tretë që të mos kryejnë veprime me këtë shoqëri, të vendosen bllokime në pasuritë e tyre etj.

19. Sipas nenit 29 të ligjit nr. 8901/2002, me hapjen e procedurave të falimentimit kreditorët duhet të mbajnë mbledhjen për raportim 45 deri 90 nga e sotme e shpalljes së këtij vendimi ku administratori duhet të japë raportin e tij për gjendjen e pasurisë së debitorit etj., kreditorët duhet të mbledhen për verifikim të pretendimeve

10–60 ditë nga dita ku përfundojnë depozitimi i pretendimeve. Po ashtu edhe çdo person i cili ka detyrime të pashlyera ndaj debitorit duhet të njoftojë administratorin e falimentimit.

20. Duke u nisur edhe nga sugjerimet e bëra nga ABSA, Agjencia e Mbikëqyrjes së Administratorëve të Falimentimit për data fikse të mbledhjeve, gjykata vendos për një përsheptim të procesit, por edhe për qartësi të tyre të caktojë datë fikse të mbledhjeve të raportimit nga administratorja dhe verifikimit të pretendimeve të kreditorëve. Kjo mënyrë nuk lë shkak për abuzivitet dhe as e zvarrit gjykimin.

21. Bashkë me hapjen e procedurës së falimentimit gjykata ka për detyrë të caktojë edhe administratorin e falimentimit, e cila jo domosdoshmërisht duhet të jetë administratorja e përkohshme e falimentimit, por për këtë gjykatë, meqenëse eksperte Mimoza Cara ka njohur të krijuara për këtë rast, si dhe raporti i kryer prej saj ishte korrekt dhe profesional dhe pa kontestime për palët, gjykata vendosi ta caktojë edhe si administatore të falimentimit. Sipas qëllimit të këtij ligji, marrëdhënia që krijojnë kreditorët, debitori me administratorin e falimentimit duhet të vishet nga besimi gjë që shikohet nga gjykata që në fazën e gjykimit të hapjes së procedurës së falimentimit.

22. Në lidhje me afatin e ankimit sipas nenit 7§3 të ligjit për falimentimin, ndaj këtij vendimi bëhet ankim i veçantë, fillon nga data e shpalljes së vendimit ose kur vendimi shpallet në mungesë të palëve, nga data kur palët marrin dijeni.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në 13§4, 18, 26, të ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) dhe nenet 126, 306–310, 102–106 të Kodit të Procedurës Civile,

#### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës si e mbështetur në ligj dhe në prova.

2. Të deklarojë, sot në datën **18 maj 2016, ora 12:00**, të hapur, procedurën e falimentimit për shkak të paaftësisë paguese, ndaj debitorit shoqëria “**AGC Retail**” sh.p.k. me NUIS: K91519017K me administrator Elson Bajlozin,



me seli në rrugën “Llambi Bonata”, kati 19/4/11, Kombinat, Tiranë Shqipëri.

3. Emërimin si administratore falimentimit, për shoqërinë “AGC Retail” sh.p.k. të znj. **Mimoza Cara**, me adresë: Pallati i Kulturës, kati i tretë Tiranë, me NUIS: K31414020T dhe celular: 00355692091209.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “AGC Retail” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, deri në datën **27 korrik 2016**, pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

5. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “AGC Retail” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit.

6. Mbledhja e kreditorëve për raportim, të mbahet në datën 27 korrik 2016, në katin e tretë, salla nr. 4 e GJRRGJ-së Tiranë, në orën 14:00.

7. Mbledhja për verifikim të pretendimeve të kreditorëve mbahet brenda **27 shtatorit 2016**.

8. Ky vendim u komunikohet kreditorëve: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria Vendore e Doganave Tiranë, “City Park” sh.a., si dhe Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, si përfaqësuese e subjekteve shtetërore.

9. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “AGC Retail” sh.p.k. dhe bërjen e veprimeve në regjistrat përkatës:

- Buletinin e Njoftimeve Publike të Qendrës së Botimeve Zyrtare;

- Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe publikimin e saj në faqen e saj elektronike;

- Dhomës Kombëtare të Noterëve;

- Regjistrat të Barrëve Siguruese;

- Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të njoftuar zyrat vendore;

- T’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve financiare jobankare të licencuara në Republikën e Shqipërisë;

- Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe publikimin e saj në faqen zyrtare elektronike;

- Autoritetit Rrugor Kombëtar pranë Ministrisë së Transporteve;

- Në faqen zyrtare elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

- Publikimin e dispozitivit të vendimit në gazetën “Shqip” dhe në gazetën “Panorama”, dy herë radhazi në faqen e parë ose gazetë tjetër të

së njëjtës natyrë që administratorja e konsideron të përshtatshme.

10. Ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm.

11. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

12. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes, ndërsa për personat e tretë në mungesë ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit, pa e ndërprerë procedurën e mëtejshme të falimentimit.

***U shpall në Tiranë, sot, në datën 18 maj 2016, ora 11:57.***

GJYQTARE  
Rezarta Mataj

#### VENDIM

Nr. 5992, datë 9.6.2016

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

**Gjyqtari: Ilir Çeliku,**

asistuar prej sekretares gjyqësore **Ornela Marashi**, sot në datën 9.6.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen civile nr. 5992 akti, që u përket palëve:

KERKUES: **Shoqëria “G&T” sh.p.k.**, me seli në Tiranë - Fushë Prezë, rruga Vorë-Fushë-Krujë, km 5, përfaqësuar në gjykim nga av. Artan Shllaku, nr. licence 3289 dhe NIPT: L41705027S.

PERSON I TRETË: **Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë**, përfaqësuar me autorizimin nr. 18783, datë 17.3.2016 nga Rovena Zoto (në mungesë).

OBJEKTI: Hapja e procedurës së falimentit të shoqërisë “G&T” sh.p.k. me NIPT: K31902010N.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 13, 15, 19/3, 30/1, “b” e vijues të ligjit nr. 8901/25.5.2002, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 10137, datë 11.5.2009, ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.



Gjykata, pasi dëgjoi palën kërkuese që kërkoi pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentit, shpalljen e falimentimit për shoqërinë “G&T” sh.p.k., personin e tretë që ndonëse kishte dijeni rregullisht për gjykimin e la në mungesë, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi dhe administroi provat shkresore të lejuara për shqyrtim,

VËREN:

Se, kërkuesi shoqëria “G&T” sh.p.k., ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një kërkesë, me objekt: “Çeljen e procedurës së falimentimit”.

Nga shqyrtimi gjyqësor, sipas pretendimeve të palës kërkuese, shoqëria “G&T” sh.p.k., ushtron veprimtari, në: “*design*, aplikime grafike, shtypshkrimin e botimeve të ndryshme, fletëpalosje, postera, ftesa, kartëvizita, reklama televizive dhe xhami ndriçues etj. Konstruksione metalike dhe veshje fasadash, importimin dhe eksportimin e artikujve të përpunuar dhe gjysmë të përpunuar të metaleve me ngjyrë për prodhim reklamash, prodhim mjetesh lundruese”. Nga ekstrakti i QKR-së, rezulton se kjo shoqëri është themeluar në datën 1.1.2003 dhe përbëhet nga katër ortakë: Përparim Kurti, Gjergji Hotova, Andon Vesho dhe Anton Topi.

Sipas pretendimeve të kërkuesit, kjo shoqëri ka rezultuar me humbje dhe për këtë arsye, përfaqësuesi i saj, i është drejtuar gjykatës duke kërkuar shpalljen e falimentit.

Pala kërkuese pretendoi në gjykim se shoqëria “G&T” sh.p.k., është në gjendje paaftësie paguese ndaj furnitorëve dhe kreditorëve të saj për detyrimet e pagueshme në datën e tyre të maturimit.

Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar gjykatës duke kërkuar shpalljen e falimentit të shoqërisë, për shkak të pamundësisë së pagimit të detyrimeve dhe paaftësisë paguese të tij.

Në gjykim, në cilësinë e personit të tretë u thirr dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Lidhur me ligjin e aplikueshëm, gjykata çmon se në rastin konkret, ndodhemi përpara një konflikti tregtar dhe legjislacioni që do të aplikohet është sa më poshtë vijon:

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi.”.

Neni 2 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndersbëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”.

Neni 3 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Realizimi i procedurave të falimentimit është detyrë e seksioneve tregtare të gjykatës së rrethit (gjykata e falimentimit).

2. Shqyrtimi i çështjeve dhe marrja e vendimeve për procedurën e falimentimit bëhet nga një gjyqtar i vetëm.”.

Neni 4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe gjykohet në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori, i cili është person juridik, ka vendbanimin ose selinë.

2. Nëse debitori e ka transferuar qendrën e veprimtarisë ekonomike të pavarur në një vend tjetër, përgjegjësia është vetëm e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku ndodhet qendra e re e veprimtarisë së debitorit.

3. Nëse debitori nuk ka seli ose vendbanim në Shqipëri, përgjegjësia i përket seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori ka një degë ose çdo pasuri tjetër.

4. Në rast se një procedurë falimentimi është deklaruar në përgjegjësi të disa seksioneve tregtare të gjykatave të rretheve, përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes, e ka seksioni tregtar i



gjykatës së rrethit ku është paraqitur fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, që ka përgjegjësi për të gjykuar një procedurë falimentimi, është gjykata e vetme përgjegjëse për të gjykuar paditë civile, që ngrihen për këtë procedurë falimentimi.”.

Neni 16 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor, anëtarët e organit drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta.

2. Në rastin e një personi juridik, çdo anëtar i organit drejtues është i detyruar të kërkojë hapjen e menjëhershme të procedurës së falimentimit, por jo më vonë se 21 ditë nga data kur personi juridik është në gjendje paaftësie paguese, në kuptim të pikës 4, të nenit 13 të këtij ligji. Këta persona janë personalisht përgjegjës për dëmshpërblimin e kreditorëve nëse kreditorët pësojnë humbje për shkak të mosparaqitjes së kërkesës brenda këtij afati 21-ditor .

3. Nëse kërkesën nuk e paraqesin bashkërisht të gjithë anëtarët e organit drejtues, të gjithë ortakët e thjeshtë të shoqërisë së thjeshtë ose të gjithë likuidatorët, kërkesa pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit nëse janë të mjaftueshme dhe bindëse shkaqet e parashtruara për hapjen e procedurës së falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, përpara se të marrë vendim, dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues, ortakët e thjeshtë ose likuidatorët.”.

Neni 4 i ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008, parashikon se:

Në nenin 13, në fund të pikës 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Procedurat për fillimin e procesit të falimentimit në organin tatimor kryhen sipas legjislacionit tatimor përkatës.”.

Neni 8 i ligjit nr. 9919, datë 19.5.2008, parashikon se:

Në nenin 17, pika 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Vlerësohen se kanë interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kreditori, i cili ka ndaj

pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror dhe autoritetet fiskale.”.

Në bazë të ligjit të sipërcituar procedura e falimentimit hapet për pasuritë e çdo personi përfshirë dhe atë juridik, siç është kërkesa në rastin objekt gjykimi dhe përpara se të jetë kryer ndarja e pasurisë (në rastet e prishjes së shoqërisë dhe futjes së saj në likuidim). Në rastin objekt gjykimi shoqëria “G&T” sh.p.k., paraqitet me një status aktiv.

Në nenin 15, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht dhe dokumentacioni që kërkohet të paraqitet bashkëngjitur kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në nenin 13/1, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak”.

Më tej, në pikat e tjera të kësaj dispozite, ligjvënësi përcakton në mënyrë të shprehur se kush janë shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit, duke mos lënë vend për interpretime apo vlerësime nga ana e Gjykatës në lidhje me shkaqet e hapjes së procedurës së falimentimit.

Këto shkaqe janë:

- “Gjendja e paaftësisë paguese”, e cila është shkak i përgjithshëm dhe ligji jep nocionin e kësaj “gjendje paaftësie paguese”;

- “Mbingarkesa me borxhe”, e cila përbën shkak hapje të procedurës së falimentimit vetëm për personin juridik (pra, jo për çdo subjekt). Dhe në lidhje me këtë shkak ligji jep nocionin e plotë të “mbingarkesës me borxhe”.

Pala kërkuese paraqiti si shkak për kërkimin e saj mbi hapjen e procedurës së falimentimit gjendjen e paaftësisë paguese dhe mbingarkesën me borxhe të shoqërisë “G&T” sh.p.k.

Në rastin konkret, mënyra e kalimit në procedurat e falimentimit për një shoqëri tregtare, parashikohet në ligjin “Për falimentimin” dhe ndryshimet përkatëse që i kanë ndodhur këtij ligji.





Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi”.

Neni 2 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndersbëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”.

Referuar dispozitave të sipërcituara, detyra kryesore e ligjit të falimentimit, është përcaktimi i modaliteteve të cilave duhet t’u nënshtrohet një subjekt tregtar, në momentin kur ai plotëson kriteret ligjore të shpalljes në faliment. Qëllimi kryesor i legjislacionit tregtar që ka të bëjë me falimentimin, është mbrojtja sa më e madhe ligjore që u bëhet kreditorëve në rastet kur një subjekt tregtar ka detyrime financiare ndaj të tretëve apo përcaktimin në mënyrë të detajuar të një plani riorganizimi për ruajtjen e veprimtarisë tregtare të tij.

Neni 3 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Realizimi i procedurave të falimentimit është detyrë e seksioneve tregtare të gjykatës së rrethit (gjykata e falimentimit) .

2. Shqyrtimi i çështjeve dhe marrja e vendimeve për procedurën e falimentimit bëhet nga një gjyqtar i vetëm.”

Neni 4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, parashikon se:

“1. Procedura e falimentimit shqyrtohet dhe gjykohet në seksionin tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori, i cili është person juridik, ka vendbanimin ose selinë.

2. Nëse debitori e ka transferuar qendrën e veprimtarisë ekonomike të pavarur në një vend tjetër,

përgjegjësia është vetëm e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku ndodhet qendra e re e veprimtarisë së debitorit.

3. Nëse debitori nuk ka seli ose vendbanim në Shqipëri, përgjegjësia i përket seksionit tregtar të gjykatës së rrethit ku debitori ka një degë ose çdo pasuri tjetër.

4. Në rast se një procedurë falimentimi është deklaruar në përgjegjësi të disa seksioneve tregtare të gjykatave të rretheve, përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes e ka seksioni tregtar i gjykatës së rrethit ku është paraqitur fillimisht kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit.

5. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, që ka përgjegjësi për të gjykuar një procedurë falimentimi, është gjykata e vetme përgjegjëse për të gjykuar paditë civile, që ngrihen për këtë procedurë falimentimi.”

Sipas këtyre dispozitave dhe mbështetur në aktet e regjistrimit të kërkuarit, në gjykim rezultoi se shoqëria “G&T” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Tiranë. Në këto kushte, për sa kohë që në gjykim nuk u paraqit ndonjë provë shkresore që të vërtetonte se kjo seli ishte ndryshuar me ndonjë vendim të mbledhjes së përgjithshme të ortakëve të personit juridik, gjykata çmon se është kompetente për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur për shpalljen e falimentimit të kësaj shoqërie.

Neni 16 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” parashikon se:

“1. Të drejtën për të kërkuar hapjen e një procedure falimentimi për pasurinë e një personi juridik e gëzon çdo kreditor, anëtarët e organit drejtues ose edhe çdo ortak i thjeshtë ose likuidator, në rastin e shoqërive të thjeshta.

2. Në rastin e një personi juridik, çdo anëtar i organit drejtues është i detyruar të kërkojë hapjen e menjëhershme të procedurës së falimentimit, por jo më vonë se 21 ditë nga data kur personi juridik është në gjendje paafitësie paguese, në kuptim të pikës 4, të nenit 13, të këtij ligji. Këta persona janë personalisht përgjegjës për dëmshpërblimin e kreditorëve nëse kreditorët pësojnë humbje për shkak të mosparaqitjes së kërkesës brenda këtij afati 21-ditor .



3. Nëse kërkesën nuk e paraqesim bashkërisht të gjithë anëtarët e organit drejtues, të gjithë ortakët e thjeshtë të shoqërisë së thjeshtë ose të gjithë likuidatorët, kërkesa pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit nëse janë të mjaftueshme dhe bindëse shkaqet e parashtruara për hapjen e procedurës së falimentimit. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, përpara se të marrë vendim, dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues, ortakët e thjeshtë ose likuidatorët.”.

Në rastin konkret, duke qenë se pala kërkuese është vetë subjekti i së drejtës në gjendje të paaftësisë paguese, gjykata çmon se kjo shoqëri legjitimohet t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar shpalljen e falimentimit të saj.

Pala kërkuese pretendoi në gjykim se shoqëria “G&T” sh.p.k., kishte deklaruar humbje tatimore për një periudhë të njëpasnjëshme, ishte në gjendjen e paaftësisë paguese e në këto kushte, referuar dispozitës së sipërcituar, kjo shoqëri duhet të kalonte në falimentim.

Gjykata çmon se një pretendim i tillë është i mbështetur në ligj e në prova, për sa më poshtë vijon:

Sipas pasqyrës së detyrimeve, kërkuesi ka rezultuar në gjendje të paaftësisë paguese për të shlyer detyrimet e tij ndaj personave të tretë.

Një fakt i tillë provohet me anë të akteve shkresore, të administruara në gjykim me cilësinë e provës.

Për të verifikuar dhe vlerësuar pretendimet e palëve në gjykim, bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe atë të kërkuar nga ligji, Gjykata në seancën e datës 21.4.2016, vendosi, në përputhje me nenin 18, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, të emërojë ekspertin kontabël, Shpresa Breçani, për të vepruar si administratore e përkohshme e falimentimit, duke e ngarkuar që t'u përgjigjet të gjitha detyrave të përcaktuara shprehimisht në këtë nen.

Administratorja e përkohshme, pasi u njoh me të gjithë dokumentacionin e paraqitur në

Gjykatë nga palët, si dhe me detyrat e lëna, paraqiti një raport në datën 30.12.2013.

Në këtë raport të administratores së përkohshme të falimentimit, konkludohet sa më poshtë vijon:

- gjendja e detyrimeve afatshkurtra të shoqërisë është 20 024 935 lekë, ku janë përfshirë gjendja e furnitorëve, detyrimet tatimore, detyrime ndaj punonjësve, hua të tjera, parapagime të arkëtuara, huamarrje dhe overdrafte etj.;

- gjendja e detyrimeve kreditore hua afatgjata është në shumën 10 630 781 lekë, me një total detyrimesh për vitin 2014, në shumën 32 510 656 lekë dhe vitin 2015 në shumën 24 527 632 lekë.

Sipas ekspertës kontabël, shoqëria “G&T” sh.p.k. është në gjendjen e mbingarkesës me borxhe, pasi pasuritë e saj nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve.

Sipas ekspertës, në kushtet kur shoqëria “G&T” sh.p.k., rezulton me humbje, pretendimi i ngritur nga pala kërkuese lidhur me plotësimin e kushteve të falimentimit për këtë shoqëri, është i mbështetur në ligj e në prova, sepse:

- shoqëria ka rezultuar me humbje financiare;  
- kapitali i saj nuk mbulon dot humbjet e pësuar gjatë viteve ushtrimore të njëpasnjëshme.

Në lidhje me verifikimin e faktit nëse pasuritë e shoqërisë mbulojnë shpenzimet e falimentimit (të përcaktuara si të tilla në nenin 37, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”), administratorja e përkohshme vëren se nga ana e debitorit është vënë në dispozicion një shumë e caktuar në masën 20 500 euro, e cila do të shërbejë për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme nga ana e administratores së përkohshme të falimentit që do të caktohet nga gjykata.

Gjithashtu, gjatë gjykimit të çështjes gjykata, duke pasur parasysh dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit në



dëm të kreditorëve. Sipas nenit 1 të këtij ligji “fillimi i procedurave të falimentimit synon të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të kreditorëve “kreditorëve””. Qëllimi i procedurës së falimentimit është që të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi, ndërmjet arritjes së një marrëveshjeje me synimin kryesor, ruajtjen e veprimtarisë së saj.

Duke qenë se kërkesa e shoqërisë “Belle Air” sh.p.k., është mbështetur në nenin 13 të ligjit “Për falimentimin”, si dhe referuar faktit se kriteret e kësaj pike rezultojnë të jenë plotësuar për kërkesin në këtë gjykim, gjykata çmon se kërkesa e paraqitur është e mbështetur në ligj e në prova e si e tillë duhet pranuar, duke vendosur hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “G&T” sh.p.k.

Referuar nenit 26/4 të ligjit “Për falimentimin”, gjykata çmon se administrator i falimentimit për kërkesin do të caktohet ekspertja kontabël e autorizuar Shpresa Breçani, në mbështetje të nenit 43 të ligjit të sipërcituar.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi, të gjitha pretendimet e tyre tek administratorja e falimentimit, duke i njoftuar asaj pretendimet dhe të drejtat e siguruar që kanë mbi pasuritë e kërkesit në këtë gjykim. Gjithashtu, të gjithë personat që kanë detyrime ndaj debitorit, duhet t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato, administratorit të falimentimit znj. Shpresa Breçani.

Një kopje e këtij vendimi, duhet t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve, të publikohet në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë palës kërkuese në këtë gjykim dhe duhet të regjistrohet në të gjithë regjistrat e tjerë, ku janë të regjistruar të drejtat e debitorit shoqërisë “G&T” sh.p.k.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126 e 308 të Kodit të Procedurës Civile,

## VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës së kërkesit shoqëria “G&T” sh.p.k.

- Hapjen në orën 15:00, të datës 9.6.2016, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., me seli në Tiranë, adresa: rruga “Vorë-Fushë-Krujë”, km i 5-të, Fushë-Prezë, Tiranë.

- Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “G&T” sh.p.k., të znj. Shpresa Breçani, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 9, datë 14.10.2014, me adresë: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë.

- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “G&T” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

- Të gjithë kreditorët e shoqërisë “G&T” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

- Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “G&T” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

- Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “G&T” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

- Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., Shpresa Breçani.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

- Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “G&T” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuessit.

- Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes për palën prezente dhe nga dita e nesërme e marrjes dijeni për personin e tretë në mungesë.

**U shpall sot, në Tiranë, në datën 9.6.2016.**

GJYQTAR  
I Iir Çeliku

**VENDIM**  
**Nr. 7306, datë 17.6.2016**

### **NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Gjyqtari **Ervin Pollozhani**, asistuar nga sekretarja gjyqësore **Lusjana Idrizi**, sot në datën **17.6.2016**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore

publike, çështjen civile-tregtare me nr. **7306 regj. themeltar** që i përket:

**KËRKUES:** **Shoqëria “Arbi-D” sh.a.**, person juridik shqiptar, i regjistruar në QKR me NIPT: K62411001D, me seli në qytetin e Tiranës, në adresën rruga “Bogdani”, përballë shkollës “Avni Rustemi”, me përfaqësues ligjor z. Kozma Biqiku, e përfaqësuar në gjykim me prokurën e posaçme nr. 410 rep., nr. 193/2 kol., datë 12.4.2016 nga av. Mariolla Ndina dhe av. Petrit Ismaili.

**OBJEKTI:** Fillimin e procedurës së falimentit për pasuritë e shoqërisë “Arbi-D” sh.a., për shkak të paaftësisë paguese dhe mbingarkesës me borxhe të saj.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 320, 334 të Kodit të Procedurës Civile; nenet 3, 4, 13, 14/1 dhe 15 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësueses së kërkuessit, e cila kërkoi: *Pranimin e kërkesës, sipas objektit të saj*, qëndrimin e administores së përkohshme të falimentit, znj. Mimoza Cara (Memoçi), nëpërmjet aktit të ekspertimit të kryer prej saj, pasi administroi provat shkresore dhe shqyrtoi çështjen në tërësi për këtë fazë të parë të kësaj procedure, në përfundim të saj

### **VËREN:**

Se, shoqëria “Arbi-D” sh.a. i është drejtuar kryesisht kësaj Gjykate, me kërkesën formale për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar, neni 15 e vijues i tij.

Në bazë të neneve 36, 41, 42 dhe 59 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe neneve 4, 13, 15, 18 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, kjo gjykatë, shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe është në kompetencën e saj lëndore e tokësore, dhe konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente nga pikëpamja e kompetencës lëndore e tokësore.

Gjithashtu, Gjykata, në vështrim të neneve 71, 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të shkaqe papajtueshmerie ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundërshtuar dhe nga pala prezente në gjykim.



Në bazë të nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 3/2 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” i ndryshuar, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

*Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se:*

Shoqëria “Arbi-D” sh.a. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë, në datën 1.11.2006. Selia e kësaj shoqërie është në Tiranë, rruga “Bogdani”, përballë shkollës “Avni Rustemi”.

Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e *lojërave të fatit*. Për këtë fushë të veprimtarisë së saj, shoqëria është licencuar si e tillë nga Ministria e Financave, Drejtoria e Lojërave të Fatit me Leje Ushtrimi Veprimtarie për Lojëra Fati, për kategorinë “Lojëra elektronike” nr. 43, datë 11 shtator 2013, kjo me një afat 10-vjeçar.

Kapitali i shoqërisë është në masën 2,000,000 lekë, e ndarë në 100 aksione me 20,000 lekë/aksioni. Aksionar i vetëm i shoqërisë është z. Arben Durmishi zotërues i 100% të vlerës së kapitalit.

Veprimtaria e kësaj shoqërie ka vazhduar rregullisht si e tillë deri në muajin dhjetor të vitit 2014, kohë pas së cilës rezultoi se shoqëria për shkak të vështirësive të saja financiare, u vu në vështirësi likuidimi të detyrimeve ndaj të tretëve. Këto vështirësi, kanë ardhur si pasojë e kushteve të vështira ekonomiko-financiare, të cilat kanë dhënë një ndikim të madh në uljen e rezultateve të saj në fushën e basteve sportive, gjobave të mëdha dhe për rrjedhojë, ajo ka pësuar një përkeqësim të gjendjes së saj financiare.

Krahas këtij fakti rezultoi se aktualisht, kësaj shoqërie i ka përfunduar vlefshmëria e licencës së dhënë nga Ministria e Financave për këtë kategori lojërash fati që prej shtatorit të vitit 2013 dhe nuk ekziston më asnjë mundësi ligjore për rinovimin e saj. Kjo, për arsytet e thjeshtë se neni 5, i ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, e përjashton kategorinë e lojërave elektronike nga kategoritë e lojërave të fatit të parashikuara dhe për pasojë nuk ekziston asnjë mundësi efektive për vazhdimësinë e kësaj veprimtarie.

Situata financiare e shoqërisë ka sjellë pasojë me mbingarkesë të borxheve që ka, pasi ajo nuk është në gjendje të tillë financiare që mund të kryejë shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare që kanë afate maturimi të mëvonshme.

Gjatë kësaj periudhe, sipas pohimit të përfaqësueses së palës kërkuese, kundër shoqërisë “Arbi-D” sh.a. kanë filluar disa procese administrative për pagime të detyrimeve me natyrë tatimore e doganore, të cilat nuk mund të ndiqen për t’u ankimuar nga ana e shoqërisë për mungesë të likuiditeteve dhe gjendjes së saj të rënduar financiare, për shkak të ngarkesës me borxhe.

Krahas kësaj, paaftësia e saj paguese shtrihet edhe në një të ardhme të afërt pasi nuk është në gjendje të paguajë ose të shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit.

Kështu rezultoi nga aktet e paraqitura në gjykim, se deri në datën 31.12.2015, shoqëria “Arbi-D” sh.a. ka detyrime për të paguar kundrejt të tretëve në vlerën totale 359.110.001 lekë.

Shoqëria ndodhet në gjendje të mbingarkesës me borxhe, pasi vlera e pasurive të saj nuk mbulon detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave, konkretisht referuar të ardhurave për vitin 2015 ato kanë qenë në masën 0 lekë. Shoqëria ka arritur në një situatë financiare që nuk premtonte apo garantonte shlyerjen e tyre.

Kështu, sipas provave shkresore të paraqitura në gjykim rezultoi se sipas shkresës nr. 497/1 prot., datë 23.2.2016, rezultoi se ndaj Autoritetit Mbikëqyrës të Lojërave të Fatit, kjo shoqëri ka detyrimin në total (detyrim gjobe + detyrim kamate) në vlerën 3.000.000 lekë.

Sipas shkresës nr. 2004/1 prot., datë 22.2.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Tiranë, kjo shoqëri rezultoi debitorë në shumën totale (detyrim + penalitet + interesave) 277,884,509 lekë.

Sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. 549 prot., datë 7.3.2016 kjo shoqëri rezultoi debitorë ndaj kësaj drejtorie në masën 474 lekë për tatim mbi fitimin, 40.000 lekë për tatim mbi lojërat e fatit, gjobë për mosmbajtje të saktë të librave në vlerën 10.000 lekë. Nuk ka detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim, tatim mbi fitimin dhe TVSH.

Më tej, nga administratori i shoqërisë, në referim të nenit 15, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” janë lëshuar/nënshkruar deklaratat, sipas së cilave, të dhënat e pasqyruara në pasqyrat financiare dhe shënimet



përkatëse të shoqëruara bashkë me listën e aktiveve afatgjata dhe inventarët janë të saktë, të plotë dhe përfaqësojnë situatën reale të shoqërisë; të dhënat dhe pasqyrat analitike të aktiveve afatgjata dhe të inventarëve janë në pronësi të shoqërisë dhe nuk janë përdorur për t'u lënë si mjet sigurimi apo janë ngarkuar me barrë të çfarëdolloj tipi tjetër.

Më tej, nga ZVRPP-ja Tiranë, rezultoi e provuar me shkresën e datës 30.5.2016 se kjo shoqëri nuk ka të regjistruar në pronësi të saja asnjë pasuri të paluajtshme.

Me vërtetimin nr. 612 prot., datë 8.6.2016, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale Tiranë, rezulton se kjo shoqëri nuk është debitorë ndaj kësaj drejtorie për taksat vjetore të mjeteve të përdorura prej saj, gjoba të kontrollit teknik apo gjoba të kontrollit në rrugë. Mjetet që kjo shoqëri ka pasur në pronësi rezultojnë të shitura prej saj sipas kontratave të bashkangjitura vërtetimit.

Po kështu, sipas gjendjes së llogarisë së kësaj shoqërie në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a. rezulton se gjendja e llogarisë së kësaj shoqërie pranë kësaj banke, si në valutë dhe në lekë, është në vlerën 0.

Nisur nga këto rrethana fakti dhe provash, për shkaqet e sipërpërmendura, pala kërkuese shoqëria “Arbi-D” sh.a., me cilësinë e debitorit i është drejtuar me iniciativën e saj, kësaj gjykate me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, gjykata vëren se: Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon shprehimisht se: “Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi.”

Ndërsa, në nenin 2 të tij parashikohet qëllimi i procedurës së falimentimit: “1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij. 2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”

Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak. 2. Gjendja e paafhtësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paafte për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paafhtësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryen pagesat... 4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë...”

Neni 14/1, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore, kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare ....”

Neni 15 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon - Kërkesa e debitorit: “1. Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj, duhet të paraqesin:

a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë;

b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, duhet të përmbajë edhe një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

3. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk i kanë dorëzuar të gjitha deklaratat dhe dokumentet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i kërkon atij plotësimin e tyre. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk e zbatojnë kërkesën e mësipërme brenda 15 ditëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit rrezon kërkesën e drejtorëve, zyrtarëve, ortakëve apo



*aksionarëve të shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, për hapjen e procedurës së falimentimit.”.*

Sa më sipër u parashtrua nga gjykata, rezultoi se nga pala kërkuese të gjitha këto akte formale detyruese u paraqitën si të tilla në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji.

Neni 18/4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “*Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit.”.*

Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “*1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur emron se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit. ç) të dhënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor përkatës... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit.”.*

Në përfundim, pas analizës së faktit, pretendimeve të palës kërkuese dhe analizës së parashikimeve në ligj, gjykata vëren se bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, ajo duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Fillimi në rrugë gjyqësore i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit:

a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim; ose/dhe

b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

Legjitimimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit e gëzon kreditori, **debitori**, si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale trevjeçare. Në rastet kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vetë subjekti debitor, ky i fundit duhet t'i evidentojë gjykatës: *listën e pasurive dhe të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë; listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre; një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.*

Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata arrin në përfundimin se pala kërkuese legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e debitorit në procedurën e falimentimit dhe ndaj pasurisë së saj vlerësohet se ka një interes me karakter pasuror.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 18 të ligjit, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuesit për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a, gjykata caktoi si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Mimoza Cara (Memoçi), së cilës iu caktuan si detyra të verifikojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtim të gjendjes së paaftësisë paguese të subjektit apo/dhe mbingarkesës së tij me borxhe, të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, të verifikojë nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregtare të debitorit.

Nga raporti i paraqitur nga administratorja e përkohshme e falimentimit u përshkrua se: Aktivet e shoqërisë “Arbi-D” sh.a. deri në datën 31.12.2015 janë: Mjetet monetare 206,829 lekë ose 0,4% e totalit të aktivitetit; aktive afatshkurtra 8,863,701 lekë ose 20.76% e totalit të aktivitetit; Inventari 4,570,409 lekë ose 10.7% e totalit të aktivitetit; aktivet afatgjata 29,063,856 lekë ose 68.06% e totalit të aktivitetit.

Detyrimet e shoqërisë “Arbi-D” sh.a. deri në datën 31.12.2015 janë: furnitorë për mallra e shërbime 74,737,049 lekë ose 20.64% të totalit të



detyrimeve; detyrime ndaj personelit 3,417,329 lekë ose 0.94%; detyrime tatimore për sigurimet shoqërore 20,640 lekë ose 0% të totalit të detyrimeve; detyrime tatimore 50,474 lekë ose 0% të totalit të detyrimeve; detyrime ndaj NJMLF 3,000,000 lekë ose 0.83%; detyrime ndaj Doganës Tiranë 277,884,509 lekë ose 76.75% dhe detyrime ndaj ortakëve 2,960,279 lekë ose 0.84% e detyrimeve.

Referuar bilancit të shoqërisë për vitin 2015, raporti i aktiveve me detyrimet është 1:8,478 pra detyrimet janë përafërsisht 8.5 herë më të mëdha se aktivet. Raporti i mësipërm tregon se vlera e aktiveve është e pamjaftueshme për likuidimin e detyrimeve të maturuara deri në datën 31.12.2015.

Sa më sipër, rezultuan këto përfundime: *Ekzistenca e shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a. është reale.* Nga provat, sipas aktit, rezulton se shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, për detyrimet e njohura prej saj ndaj kreditorëve (referuar bilanceve dhe deklaratave të dorëzuara në gjykatë);

Sipas gjendjes së likuiditetit, në deklaratat e datës 15.3.2016, rezulton se debitori nuk ka mjete paguese të mjaftueshme, nuk përmbush në afatin e maturimit detyrimin ndaj kreditorëve të tij dhe si rrjedhojë plotëson kushtin e gjendjes së paaftësisë paguese. Detyrimet e mësipërme janë konsideruar nga debitori si të maturuara dhe është përgjegjësi e tij llogaritja e datës së maturimit të detyrimeve. Shoqëria nuk i ka përmbushur në kohë dhe tërësisht këto detyrime. Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë detyrimet që kanë datën e maturimit dhe të përmbushë tërësisht këto detyrime kur të maturohen. Mbingarkesa me borxhe, raporti i aktiveve me detyrimet është 1:8,478, pra detyrimet janë 8.5 herë më të mëdha se aktivet.

Pasuritë e debitorit mbulojnë (janë të mjaftueshme) shpenzimet e procedurës së falimentimit, kjo sipas analizës së bërë nga administratorja e përkohshme e falimentit në lidhje me mjetet monetare, arkë bankë, klientë për mallra dhe shërbime, si dhe materiale të ndryshme.

Debitori nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë tregtare për shkak të pamundësisë ligjore për rinovimin e lejes së ushtrimit të aktivitetit.

Në lidhje me nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, administratorja e përkohshme e falimentimit ka çmuar se në fillim duhet të evidentohet, vërtetohet dhe vlerësohet pasuria në momentin e këtij verifikimi dhe pastaj të merren masa për sigurimin e saj.

Sa më lart dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e dy prej shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, siç janë *mbingarkesa me borxhe dhe paaftësia paguese*, gjykata, në bazë të neneve 18/4/c dhe 26, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar, vendos pranimin e kërkesës dhe hapjen në orën 09:45, të datës 17.6.2016 të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a, duke emëruar si administratore të falimentimit znj. Mimoza Cara (Memoçi).

Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Arbi-D” sh.a., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të ligjit, “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet:

- Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit shoqërisë “Arbi-D” sh.a., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-





D” sh.a., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

- Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shekulli”.

Bazuar në nenin 8/2, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), për kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike, sipas nenit 9 të ligjit dhe caktimin e mbledhjeve brenda afateve të parashikuara në këtë vendim, ngarkohet administratorja e falimentimit znj. Mimoza Cara (Memoçi). Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit. Si rrjedhim, një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet dhe administratores së falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a. znj. Mimoza Cara (Memoçi).

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, që përbëhen nga taksa mbi aktet, shpenzimet për ekspert dhe shpenzimet për njoftime, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, i ngarkohen palës kërkuese.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306-308 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar),

#### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit, shoqëria “Arbi-D” sh.a.

2. Hapjen në orën 09:45, të datës 17.6.2016, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., me administrator z. Kozma Biçiku, me seli në adresën: rruga “Bogdani” përballë shkollës “Avni Rustemi”, Tiranë, Shqipëri.

3. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “Arbi-D” sh.a., të znj. Mimoza Cara (Memoçi), e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 13, datë 15.10.2012, me adresë: Pallati i Kulturës, kati i tretë nga parkimi, Tiranë me NIPT: K31414020T dhe me cel: 069 20 91 209.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Arbi-D” sh.a., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Arbi-D” sh.a., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit, znj. Mimoza Cara (Memoçi).

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., znj. Mimoza Cara (Memoçi).

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive, të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.



13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’u dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

18. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

19. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

20. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Arbi-D” sh.a., në dy gazeta me qarkullim kombëtar: gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shekulli”.

21. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.

22. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij.

**23. U shpall sot, në datën 17.6.2016, në Tiranë, ora 9:45.**

GJYQTAR  
Ervin Pollozhani

## NJOFTIM

**Nr. 1113/4, datë 26.5.2016**

Drejtuar: Shoqërisë “Kurum International” sh.a.

Adresa: Njësia Administrative nr. 5, rruga “Ibrahim Rugova”, pallati nr. 14 KT, “Green Park”, apartamenti nr. 39, kati 6, NIPT: K02727230T

Shoqërisë “Albanian Oil Refinery” sh.a.

Adresa: Rruga “Jul Variboba” nr. 1/21, Tiranë ose ish-Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan NIPT: L32104004E.

Lënda: Dërgohet njoftim mbi zgjidhjen e Kontratës Koncesionare për Rehabilitimin e Rafinerisë së Cërrikut

Të nderuar,

Në bazë të Kontratës Koncesionare, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 24.7.2013, *“Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “ROT” (rehabilitim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International” sh.a., për rehabilitimin e rafinerisë së Cërrikut, rrethi Elbasan”*, shoqëria juaj ka marrë përsipër zbatimin e projektit për rehabilitimin e rafinerisë së Cërrikut dhe vënien e saj në zbatim, në përputhje me parashikimet e kontratës dhe sipas një projekti zbatimi të miratuar nga autoriteti kontraktor.

Sikurse jeni në dijeni, që nga momenti i nënshkrimit të kontratës, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor janë dërguar disa njoftime në adresë të shoqërisë Koncesionare, lidhur me mospërmbushje të detyrimeve kontraktore, mospërmbushje të cilat cenojnë në mënyrë thelbësore interesin e Autoritetit Kontraktor.

Së fundmi, nga ana e Autoritetit Kontraktor, me anë të shkresës nr. 1113, datë 10.02.2016, Ju kemi njoftuar për fillimin e procedurave për zgjidhjen e kontratës koncesionare për rehabilitimin e Rafinerisë së Cërrikut dhe arsyet përkatëse.

Shkurtimisht, arsyet që detyruan Autoritetin Kontraktor për të bërë njoftimin e mësipërm, janë:

1. Nga ana juaj janë disponuar asete të objektit të koncesionit, në kundërshtim me kushtet e kontratës koncesionare dhe pa e njoftuar Autoritetin Kontraktor.

2. Në shkelje të Kontratës Koncesionare, nuk është dërguar për miratim projekti i rishikuar i zbatimit, në përputhje me sugjerimet e Autoritetit Kontraktor.



3. Nga ana juaj nuk është respektuar legjislacioni në fuqi në kryerjen e punimeve të natyrës ndërtimore, pa marrë lejet përkatëse në institucionet kompetente.

4. Nuk janë dorëzuar dokumente që vërtetojnë kapitalet financiare që i janë destinuar projektit të rafinerisë.

Nga ana juaj, me anë të shkresës nr. 20, datë 11.3.2016, kenë dërguar argumentimet lidhur me shkeljet e konstatuara nga ana e Autoritetit Kontraktor. Në analizë të argumenteve tuaja shprehemi si më poshtë:

1. Lidhur me disponimin e asetëve të objektit koncesionar, nga ana juaj mbahet qëndrimi se disponimi i lirshëm i pajisjeve është parashikuar në kontratën koncesionare, ku në bazë të nenit 4, përcaktohet se: *Që në datën e hyrjes në fuqi, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili i pranon të drejtat ekskluzive për të gjithë afatin: i) të projektojë, të financojë, të rehabilitojë, të testojë, të ketë në pronësi, të operojë dhe të mirëmbajë kompleksin e objekteve të rafinerisë dhe territorin përkatës.*

Lidhur me sa më sipër, shprehemi se megjithëse kontrata koncesionare jep të drejta ekskluzive mbi objektin e koncesionit, në bazë të nenit 10, përcaktohet se gjithë zbatimi i projektit do të bëhet vetëm pas miratimit të tij, në përputhje me nenin 6 të kontratës. Në bazë të nenit 6, përcaktohet se Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës konform termave dhe kushteve të tij dhe se projekti i zbatimit duhet të miratohet nga Autoriteti Kontraktor (pika 6.1, neni 6).

Në këtë kuptim, veprimi juaj për shitjen e asetëve të objektit koncesionar, pa u parashikuar në projektin e zbatimit dhe pa miratimin nga Autoriteti Kontraktor, është në kundërshtim me kontratën dhe si i tillë argumenti i dërguar nga ana juaj nuk qëndron.

Nëpërmjet disa komunikimeve zyrtare, konkretisht shkresave nr. 1122/4, prot., datë 16.4.2015, nr. 7500/8 prot., datë 11.5.2015, nr. 7500/12 prot., datë 7.8.2015, Autoriteti Kontraktor i ka kërkuar shoqërisë “Albanian Oil Refinery” marrjen e masave për riparimin e kësaj shkeljeje. Nga ana juaj në vazhdimësi është refuzuar marrja e masave të kërkuara, duke cenuar jo vetëm kushtet e Kontratës Koncesionare, por edhe raportin e mirëbesimit që duhet të qëndrojë në themel të marrëdhënieve kontraktore.

2. Lidhur me mosdorëzimin e projektit të zbatimit të objektit të kontratës, në përputhje me rekomandimet e Autoritetit Kontraktor, nga ana juaj argumentohet se ligji nr. 9663/2006, “Për koncesionit”, nuk parashikon në asnjë nen të tij format “ROT” apo “BOT” dhe si e tillë nuk ka asnjë ndarje të prerë ndërmjet këtyre formave.

Lidhur me këtë pretendim, sqarojmë se forma e koncesionit është përcaktuar që në titullin e kontratës koncesionare, ku përcaktohet se kontrata do të jetë e llojit “ROT” (rehabilitim, operim, transferim). Për më tepër, edhe në përmbajtje të kontratës palët kanë mbajtur të njëjtin qëndrim. Kështu në bazë të nenit 2, “Objekti i koncesionit”, përcaktohet se objekti i kontratës lidhet me *financimin, projektimin, rehabilitimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e objektit “Rafineria e Cërrikut” dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.* Si i tillë, objekt i kontratës nuk është ndërtimi nga e para e një rafinerie, por rehabilitimi i rafinerisë ekzistuese të Cërrikut.

Për më tepër, në rast të lejimit të ndërtimit të një rafinerie të re, do të ishim para shkeljes së dokumenteve të tenderit, që kanë përcaktuar si objekt të koncesionit formën “ROT”.

Mosmarrja e masave nga ana juaj, për rishikimin e projektit në mënyrë që të përputhet me vërejtjet e Autoritetit Kontraktor lidhur me elementet e projektzbatimit për pothuajse 1 vit, ka vendosur në një pozitë të disfavorshme Autoritetin Kontraktor, për shkak të dëmeve që i krijohen si rezultat i vonesës së rehabilitimit dhe vënies në punë të kësaj vepre.

3. Për sa i përket kryerjes së një pune ndërtimore pa leje përkatëse nga institucionet kompetente, nga ana juaj pranohet që është kryer në mënyrë të paligjshme, por argumentohet me domosdoshmërinë e mbrojtjes së objektit koncesionar. Nga ana juaj pretendohet se, edhe sikur ky fakt të konsiderohet shkelje, nuk mund të përbëjë shkak për prishjen e kontratës së koncesionit, pasi nuk i ka shkaktuar asnjë dëm Autoritetit Kontraktor.

Lidhur me këtë qëndrim, sqarojmë së pari, që një veprim i tillë është në shkelje të kushteve të kontratës koncesionare, ku në bazë të nenit 6, pika 6.1.13 dhe 6.1.14, parashikohet se Koncesionari/-shoqëria koncesionare, duhet të respektojë dhe të



zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave dhe rregullave të sigurimit teknik, të disiplinës teknike etj.

Mosrespektimi i legjislacionit të planifikimit të territorit është dëshmi e mungesës së seriozitetit dhe korrektesës në raport me Autoritetin Kontraktor dhe të administrimit të pronës dhe asetëve publike. Është e vërtetë që kjo shkelje në vetvete nuk konsiderohet thelbësore për kushtet e kontratës, por sidoqoftë e vlerësuar në tërësinë e shkeljeve, ndihmon Autoritetin Kontraktor për të gjykuar mbi paaftësinë dhe neglizhencën tuaj në zbatimin e objektit koncesionar.

4. Lidhur me konstatimin e dështimit tuaj për të siguruar financimin e projektit brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kontratës, nga ana juaj nuk jepet argumentim dhe informacion i detajuar, por përcaktoni se keni komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me Autoritetin Kontraktor rreth sigurimit të financimit dhe keni depozituar dokumentet përkatëse.

Ndërkohë, në bazë të parashikimeve të Kontratës, detyrimi juaj ishte që brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kontratës të siguronit financimin e projektit. Shoqëria koncesionare/-Koncesionari nuk ka përcjellë akoma pranë Autoritetit Kontraktor dokumentet apo informacionin e nevojshëm, që të provojë mënyrën e financimit të veprës.

Në përfundim të gjithë sa më sipër, Autoriteti Kontraktor, çmon se shkeljet e Koncesionarit/-shoqërisë koncesionare, të cilat nuk janë riparuar për një kohë të gjatë, përbëjnë mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve të Kontratës e në këtë kuptim, cenojnë në mënyrë thelbësore interesat e Autoritetit Kontraktor.

Sa më sipër, në bazë të nenit 10 të Kontratës së Koncesionit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ju njofton që e konsideron të zgjidhur në mënyrë të njëanshme Kontratën Koncesionare.


Brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të merrni masa për të inventarizuar dhe për të dorëzuar të gjitha asetet dhe pajisjet në përputhje me kërkesat ligjore të inventarizimit dhe kontabilitetit.

Deri në marrjen e asetëve në dorëzim nga ana e Autoritetit Kontraktor, keni përgjegjësi për ruajtjen dhe administrimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti Kontraktor do të paraqitet me përfaqësuesit e tij, për të marrë në dorëzim asetet.

Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të adresojë kërkesa për çdo dëm që i është shkaktuar si rezultat i keqadministrimit apo mospërmbushjeve të detyrimeve kontraktore.

Ju faleminderit,

MINISTRI I ENERGJISË DHE  
INDUSTRIË  
**Damian Gjikhuri**



ME  
113/4

Shoqëria "Albanian Oil Refinery" K.G.

Rr. "Jel Vautica, nr. 1/11, Tiranë"

ose i.d. Kombinati Metalurgjik  
Brazda e re, Elbasan

Grupet e mbyllur në gjendje ngjeri







51  
3/

D. J. Jusufi

2.6. '16

12/11/16

Shopwise

163

11/11/16



Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2016**